



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AC-I-22-0393-A0001

Në çështjen juridike të:

Paditësi/ankuesi

R Q- i përfaqësuar nga K B, Prishtinë.

Kundër:

E paditura

N.SH "Auto Prishtina" (në likuidim), Prishtinë, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lakrishte, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJSK), i përbërë nga Mr. Sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të parashtruar kundër Aktgjykimit të Shkallës së parë të DHPGJSK-së C-IV.-15-0710, të datës 16 qershor 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 07 mars 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa e paditësit është e bazuar.**
- 2. Anulohet Aktgjykimi i Shkallës së parë të DHPGJSK-së C-IV.-15-0710, të datës 16 qershor 2022.**
- 3. Lënda kthehet në rigjykim në shkallë të parë të DHPGJS-së.**
- 4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për këtë procedure ankimore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Më 29 prill 2015, paditësi kishte parashtruar padi në DHPGJSK, kundër të paditurës AKP-së, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e tij dhe të detyrohet e paditura që t'ia kompensojë shumën 7,410.00 euro, në emër të kompensimit dhe pagave për periudhën nga tetori i vitit 2003 e deri në qershor të viti 2014, si punëtor i NSH "Auto Prishtina" (në likudim). Paditësi në padi ka theksuar se ka qenë i punësuar pranë NSH-së "Auto Prishtina" dhe se pala e paditur me shkresën me numër të protokollit 15373, ishte njoftuar për fillimin e procesit të likuidimit të Ndërmarrjes i cili ka filluar me datën 21.07.2014. Po ashtu është njoftuar edhe për anulimin e të gjitha kontratave të punës të cilat deri atëherë kanë qenë në fuqi. Më datën 12 qershor 2014 se bashku me të punësuarit e tjerë në ndërmarrje nëpërmjet menaxhmentit dhe kryesisë së sindikatës kishin depozituar një regjistër e cila përmbante emrin dhe mbiemrin e secilit të punësuar në ndërmarrje, pagat mujore, akontacionet e marra nga NSH-ja, dhe pagat që kishin mbetur të pa paguara për periudhën nga tetori 2003 e deri në qershor 2014, dhe se regjistrin në fjalë me datën 12 qershor 2014, i'a kanë dorëzuar palës së paditur.

Paditësi kishte theksuar se në mes të menaxhmentit, këshillit drejtues dhe sindikatës në njërën anë dhe ndërmarrjeve private me pronarë B S ishin krijuar raporte të dëmshme për NSH dhe se menaxhmenti në bashkëpunim me palën e paditur nuk kishin arritur t'i normalizojnë këto raporte, si rezultat i këtyre raporteve pala paditëse është dëmtuar me mos pagesë të pagave për periudhën nga tetori 2003 e deri në qershor 2017. Në vazhdimësi ka kërkuar kompensimin e pagave mujore sipas kontratës së punës deri në njoftimin në lidhje me procesin e likuidimit të ndërmarrjes. Pran Autoritetit të Likuidimit ka parashtruar kërkesë brenda afatit ku ka kërkuar kompensimin, mirëpo Autoriteti i likuidimit e ka refuzuar kërkesën për kompensimin e pagave edhe përkundër faktit se kërkesa ka qenë e parashtruar brenda afatit dhe ka pasur prova të mjaftueshme. Paditësi në padi i ka propozuar gjykatës që ta aprovojë në tersi si të bazuar kërkesën e tij dhe të detyrohet pala e paditur që palës paditëse t'ia paguajë borxhin-pagat e pa paguara për periudhën nga tetori 2003 e deri në qershor 2014 , në shumën e përgjithshme prej 7,410.00 euro me normë të kamatës prej 3.5 % në vit. Paditësi ankesës i ka bashkangjitur:

autorizimin për përfaqësim, numrin e regjistrimit të përkohshëm të subjektit afarist 80077394 të SH.A "Auto Prishtina", njoftimin drejtuar AKP-së për ushtrimin paditës kundër AKP-së, 2 njoftime të AKM-së drejtuar B S të vitit 2004, një listë të punëtorëve aktiv të cilët nuk i kanë marrë pagat për 130 muaj sipas kontratës së punës, kontratën e punës të vitit 2003, librezën e punës, dhe një deklaratë të tij.

Më 08 nëntor 2017, e paditura në mbrojtjen e saj të parashtruar kundër ankesës së paditësit theksoi se i kundërshton të gjitha pretendimet e paditësit duke i konsideruar të pa bazuar në ligj dhe si të tilla duhet të refuzohet dhe të vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit. E paditura theksoi se NSH, "Auto Prishtina" ka hyrë në procedurën e likuidimit më 21 korrik 2014, më datën 11 shtator 2014, pala paditëse pranë saj ka parashtruar kërkesë me të cilën ka kërkuar kompensimin e pagave në shumën prej 7,410.00 euro. Autoriteti i Likuidimit me vendimin PRN126-0080, të datës 31 mars 2015, e ka refuzuar kërkesën e parashtruar nga paditësi në atë procedure. Ka shtuar se Autoriteti i Likuidimit e ka marrë vendimin për refuzimin e kërkesës duke u bazuar në nenin 36.2 1 Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 dhe nenit 608 të ligjit për punën e Bashkuar (i aplikueshëm sipas nenit 1 të rregullores së UNMIKUT 199/24 është përcaktuar se pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo secilës kërkesë të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të jetë e parashkruar për tri vite.

E paditura kishte theksuar se Autoriteti i Likuidimit ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se saktë i ka zbatuar edhe dispozitat ligjore. E paditura thekson se pretendimet e paditësi janë parashkruar ngase nuk ka asnjë prove që para Autoritetit të Likuidimit, parashtruesi ka dorëzuar kërkesë pranë gjykatës apo organit tjetër kompetent nga tetori i vit 2003. Më tutje ka shtuar se asetet e ndërmarrjes janë dhënë me qira për gjatë periudhës kontestuese dhe se ndërmarrja nuk ka kryer asnjë funksion të saj, por menaxhmenti vet i ka emëruar ka marrë të ardhura nga qiradhënia e asetëve të NSH-së. Ka shtuara se paditësi nuk ka parashtruar prova që e mbështetë pretendimin se ka kërkuar kompensimin e borxhit të pretenduar dhe se nuk ka parashtruar padi në gjykatë para datës 01 tetor 2006.

Më 16 qershor 2022, Shkalla e parë e DHPGJSK-së kishte marrë Aktgjykim C-IV-15-0710, me të cilin e kishte refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Shkalla e I-rë ka arsyetuar se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune në NSH "Auto Prishtina", gjë që ishte vërtetuar nga kontrata e punës e cila gjendet në shkresat e lëndës. NSH "Auto Prishtina" me datën 21 korrik 2014, ka hyrë në procedurën e likuidimit, ku Autoriteti i Likuidimit duke u bazuar në nenin 8 të Shtojcës së Ligjit me nr.04/L034, për AKP-në në të cilin parashihet se "mesnatën e datës së vendimit për likuidim, ndërpriten të gjitha kontratat e punës që kanë qenë në fuqi deri atëherë ndërmjet ndërmarrjes dhe punonjësve të saj, nëse të tilla ekzistojnë", i ka ndërprerë të gjitha kontrata ekzistuese. Tutje ka arsyetuar se paditësi pranë Autoritetit të Likuidimit me datën 11.09.2014, ka parashtruar kërkesë për kompensim të pagave të pa paguara. Autoriteti i Likuidimit e ka shqyrtuar kërkesën e parashtruar nga pala paditëse dhe me vendimin PRN 126-0080, të datës 31 mars 2015, kërkesën e paditësit e ka refuzuar si të pa bazuar.

Shkalla e I-rë e DHPGJSK-së ka arsyetuar se paditësi ka pretenduar në borxh për shkak të mos pagimit të pagave e që i referohet periudhës nga tetori 2003 e deri në qershor 2014, ndërsa në anën tjetër pala e paditur ka pretenduar se në rastin konkret borxhi i pretenduar nga paditësi është parashkruar. Shkalla e I-rë ka konstatuar se në bazë 376 paragrafi 1 të LMD-së (1978) në mënyrë shprehimore është e përcaktuar se "kërkesa e shpërblimit të demit të shkaktuara parashkruhet për tri vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin". Në rastin konkret borxhi i pretenduar nga pala paditëse i përket periudhës nga tetori i vitit 2003 e deri në qershor 2014, andaj në kuptim të dispozitës ligjore të cituar kërkesa e paditësit është refuzuar.

Më 13 korrik 2022, paditësi/ankuesi ka parashtruar ankesë kundër aktgjykimit të Shkalla e I-rë C-IV-15-0710, për shkak të të gjitha arsyeve ankimore duke propozuar që të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar dhe lënda të kthehet në rishqyrtim ose rivendosje në Shkallë të I-rë të DHPGJSK-së.

Paditësi në ankesën e parashtruar e kundërshton arsyetimin e aktgjykimit dhe thekson se i njëjti është kontradiktor ngase sipas arsyetimit se parashkrimi i

kërkesës mund të krijohet nëse pala e dëmtuar nuk e kërkon të drejtën e vet brenda tri vitesh, këtu nuk është ky rast, sepse jo që nuk e ka kërkuar borxhin paditësi, por me pagesën e akontacionit prej 80.00 euro në muaj, gjatë tërë periudhës prej tetorit 2003 e deri në qershor të vitit 2014, në rastin konkret e paditura e ka pranuar borxhin duke e ndërprerë kështu parashkrimin. Shton se për më tepër, në këtë pjesë aktgjykimi është edhe kontardiktor në raport me provat si në shkresat e lëndës, kjo ngase në po të njëjtin paragraf gjykata vlerëson se borxhi i përket periudhës nga viti 2003 deri në vitin 2014 derisa në shkresat e lëndës ekzistojnë prova materiale që dëshmojnë raportin juridik të punës me të drejta dhe detyrime mes paditësit dhe të paditurës NSH "Auto Prishtina" deri në fillimin e likuidimit të saj në vitin 2014, derisa padia është paraqitur në vitin 2015, atëherë si është e mundur që të jetë parashkruar kërkesa. E aq më tepër kur vetë e paditura ka hartuar listën me nr. 4 të datës 12 qershor 2014 me emrat e punonjësve të cilët kanë mbetur pa i'u paguar pagat nga e paditura N.SH "Auto Prishtina". Paditësi thekson se gjatë periudhës kontestuese ka qenë i rregullt në orar dhe detyrat e tij të punës-urdhëresat e punës në vendin e punës, e në rastin konkret vlen të theksohet se sikurse paditësi dhe kolegët e tij janë diskriminuar nga e paditura për përfitime personale të individëve të caktuar të cilët kanë manipuluar me këtë NSH. Ankuesi konsideron se duke i pas parasysh të gjitha këto, nuk mund të vjen në shprehje parashkrimi i kërkesës për pagesën e pagave në këtë çështje juridike. Paditësi po ashtu thekson se nuk është kontestuese se ishte i punësuar tek e paditura deri në ditën e fillimit të procedurës së likuidimit të paditurës NSH "Auto Prishtina". Nuk është kontestuese se kishte kontratë të punës sipas të cilës ishte caktuar lartësia e pagës, dhe nuk është kontestuese se vet e paditura me Listën e punëtorëve aktiv të cilët nuk i kanë marrë rrogat sipas kontratës së punës të evidentuara më nr.4 të datës 12 qershor 2014 e kishte pohuar ekzistimin e detyrimit në emër të pagës së paguar për tani ankuesin në shumën tani të kërkuar, andaj në rastin konkret kur borxhi është pranuar nga e paditura më datë 12 qershor 2014 nuk mund të vjen në shprehje parashkrimi i kërkesës, siç pretendon gjykata e shkallës së I-rë në aktgjykimin e atakuar.

Ankuesi thekson se padia ishte dorëzuar në gjykatë më 29 Prill 2015, pa thirrë seancë përgatitore ka marrë aktgjykimin më 16 qershor 2022, pa kërkuar asnjë

veprim procedural, përveç kërkesës për pagimin e taksës gjyqësore. Ankuesi konsideron se në këtë duke marrë paarsysh nenin 5 par.1 të LPK-së në këtë rast ka pasur shkelje flagrante të parimit të kontradiktoriaritetit të palës në procedure, përkatësisht pasi që në këtë rast nen përcaktohet se "5.1 Gjykata do t'i jap mundësi secilës pale që të deklarohet rreth kërkesave dhe thënieve të palës kundërshtare", kjo ngase palëve ndërgjygjëse në këtë çështje juridike nuk iu është dhënë mundësia e deklarimit lidhur me provat e prezantuara si në shkresat e lëndës. Padiësi thekson se parimi i kontradiktoritetit paraqet kategori kushtetuese i përcaktuar në nenin 31 par 1 të Kushtetutës së Kosovës dhe është i paraparë edhe në nenin 6 të Konventës Evropiane për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut dhe akte tjera ndërkombëtare. Përveç kësaj në rastin konkret është shkelur edhe dispozita e nenit 7 par 3 të LPK-së në të cilën përcaktohet se: "Gjykata mund të bazojë vendimin e vet në faktet dhe provat lidhur me të cilat palëve nuk u është dhënë mundësia të deklarohen", ndërsa në rastin konkret gjykata ka marrë aktgjykimin duke u bazuar në fakte dhe prova për të cilat nuk janë deklaruar palët ndërgjygjëse, duke marrë paarsysh natyrën e lëndës.

Më 12 dhjetor 2023, Kolegji i Apelit këtë ankesë e ka dërguar tek AKP për përgjigje. Në përgjigjen e datës 21 dhjetor 2023, AKP konsideron se aktgjykimi i Shkallës së parë është i bazuar në ligj dhe si i tillë duhet të konfirmohet. E paditura thekson se lidhur me argumentet e ankesës është qartësisht dhe mjaftueshëmerisht e sqaruar në mbrojtjen e parashtruar si dhe në Aktgjykimin me nr.C-IV-15-0710 të DHPGJS-së, pranë Shkallës së I-rë. Përsëritja e këtyre argumenteve të cilat janë parashtruar më parë do të ishin të padobishme për mbarëvajtjen e procedurës, për këtë arsye pala kundërshtare i parashtron Kolegjit të Apelit që t'i referohet mbrojtjes dhe aktgjykimit përkatës. AKP ka propozuar që të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të vërtetohet aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e paditësit është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP) , Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj i njëjti anulohet dhe lënda kthehet në rigjykim.

Shkalla e parë e DHPGJSK-së kishte marrë Aktgjykim me të cilin refuzohet si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit R Q e parashtruar kundër të paditurave Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe Ndërmarrja Shoqërore "Auto Prishtina" (në likuidim) me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Agjencia Kosovare e Privatizimit që në emër të pagave të pa paguara për periudhën tetor 2003-qershor 2014, t'ia kompensoje shumën prej 14,410.00 euro. Shkalla e I-rë kishte arsyetuar se në bazë 376 paragrafi 1 të LMD-së (1978) në mënyrë shpërthimore është e përcaktuar se "kërkesa e shpërblimit të demit të shkaktuara parashkruhet për tri vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin". Në rastin konkret ishte konstatuar se borxhi i pretenduar nga pala paditëse i përket periudhës nga tetori i vitit 2003 e deri në qershor 2014, andaj kërkesa e paditësit për shkak të parashkrimit ishte refuzuar.

Paditësi/ankuesi nuk pajtohet me aktgjykimin e Shkallës së I-rë C-IV-15-0710 dhe në ankesën e tij të parashtruar kundër këtij aktgjykimit, e kundërshton arsyetimin e aktgjykimit dhe ka theksuar se është kontradiktor ngase sepse paditësi vazhdimisht e ka kërkuar borxhin, por edhe me pagesën e akontacionit prej 80.00 euro në muaj, gjatë tërë periudhës prej tetorit 2003 e deri në qershor të vitit 2014, në rastin konkret e paditura e ka pranuar borxhin duke e ndërprerë kështu

parashkrimin. Ai thekson se derisa në shkresat e lëndës ekzistojnë prova materiale që dëshmojnë raportin juridik të punës me të drejta dhe detyrime mes paditësit dhe të paditurës NSH "Auto Prishtina" deri në fillimin e likuidimit të saj në vitin 2014, derisa padia është paraqitur në vitin 2015, atëherë si është e mundur që të jetë parashkruar kërkesa. E aq më tepër kur vetë e paditura ka hartuar listën me nr. 4 të datës 12 qershor 2014 me emrat e punonjësve të cilët kanë mbetur pa i'u paguar pagat nga e paditura N.SH "Auto Prishtina".

Kolegji i Apelit pasi që shqyrtoi pretendimet e palëve, dhe analizoi në detaje shkresat e lëndës erdhi në përfundim se pretendimet e paditësit/ankuesit janë të bazuara.

Kolegji i Apelit nuk pajtohet me gjetjet dhe konstatimet e Shkallës së I-rë të DHPGJSK-së se në bazë 376 paragrafi 1 të LMD-së (1978), kërkesa e paditësit për pagat e papaguara është parashkruar.

Kolegji i Apelit vëren se NSH, "Auto Prishtina", kishte hyrë në procedurë të likuidimit me datë 21 korrik 2014.

Paditësi në Shkallë I-rë kishte dorëzuar si provë një listë të punëtorëve aktiv të cilët nuk i kanë marrë rrogat sipas kontratës së punës e datës 12 qershor 2014 e nxjerrë nga vet N.SH-ja. Në këtë listë shihet që vet N.SH e pohon shumën e borxhit që e ka ndaj paditësit.

Kolegji i Apelit vlerëson se kërkesa e paditësit nuk mund të konsiderohet tërësisht e parashkruar për faktin se i njëjti kishte parashtruar si provë, një listë të punëtorëve aktiv të cilët nuk i kanë marrë rrogat sipas kontratës së punës e datës 12 qershor 2014. Kjo d.m.th se 36 muaj paraprak deri në momentin kur NSH-ja kishte hyrë në procedurë të likuidimit me datë 21 korrik 2014 nuk ishin parashkruar.

Në këtë listë vërehet se organet kompetente të N.SH-së kishin pranuar faktin se ndaj punëtorëve në fjalë në mesin e të cilëve ishte edhe paditësi nuk ishin paguar në tërësi pagat për muajt e kërkuar. Kjo parashtresë kishte ndërprerë parashkrimin.

Kolegji i Apelit vëren se Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me rastin e vendosjes së kësaj çështje e përmend Vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN126-0080 të datës 31 mars 2015, me të cilin ishte shqyrtuar kërkesa e paditësit për kompensimin e pagave të papaguara. Vendimi në fjalë nuk gjendet në shkresat e lëndës. As paditësi në asnjë parashtrësë të veten nuk ishte thirrur në vendimin në fjalë.

Andaj Kolegji i Apelit konsideron se për rastin në fjalë, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së kishte vendosur në merita pa i shqyrtuar kushtet e pranueshmërisë së ankesës të parapara në nenin 74 të Ligjit për DHPGJS-në.

Për këto arsye Kolegji i Apelit e udhëzon Shkallën e I-rë të DHPGJS-së që së pari të trajtoj pranueshmerinë e padisë, dhe vetëm pas plotësimit të kushteve të pranueshmërisë të vendosë për meritat e çështjes. Gjithashtu Shkalla e I-rë duhet të marrë për bazë edhe provat tjera dhe listën e lartcekur e cila kishte ndërprerë parashkrimin dhe të marrë vendim për çështjen në fjalë.

Prandaj, Kolegji i Apelit vlerëson se ankesa e paditësit është e bazuar mbi arsyet e cekura më lartë dhe Aktgjykimi i ankimuar nuk është i drejtë e si i tillë duhet të anulohet dhe lënda të kthehet në rigjykim në shkallë të parë.

Andaj në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Taksat gjyqësore

Pasi që Taksat gjyqësore janë paguar konform nenit 13.3 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore të nxjerrë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ankuesit nuk ngarkohen me taksë gjyqësore shtesë.

Vendosur nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, më 07 mars 2024.

Mr.Sc Sahit Sylejamni, Gjyqtar kryesues _____